

NDIHMESA E MITHAT FRASHËRIT PËR GJUHËN SHQIPE

Abdurrahim MAXHUNI¹

^{1*} Prishtina Institute of Albanology

*Corresponding author e-mail: amaxhuni44@hotmail.com

Përmbledhje

Rrugën e familjarëve të tij rilindës e vazhdoi edhe Mithat Frashëri, i cili që nga viti 1905 filloi të botonte shkrime të ndryshme politike e gjuhësore. Përmes tyre, ai do të trajtonte probleme që prekun palcën e kombit, atë të gjuhës dhe të historisë së tij. I rritur në një familje ku gjuha shqipe lartësohej, nuk do të mund të qëndronte indiferent karshi gjuhës, karshi laramanisë së përdorimit të saj, karshi shkarjeve të saj. Pjesëmarrja në dy kongrese të rëndësishme, brenga e tij për gjuhën, kultivimi i saj, shpërfaqja e vlerave të saj dhe ruajtja e saj, janë elemente që e përcaktojnë identitetin e tij prej rilindësi. Në këtë kumtesë do të paraqesim ndihmesën e tij në disa shkrime të botuara në përmbledhjen *Vepra të zgjedhura 1-8*, të botuara në Tiranë.

Fjalët kyçe: Mithat Frashëri, gjuha shqipe, Kongresi i Manastirit, ndihmesa gjuhësore.

Hyrje

Përpjekja më e madhe për një gjuhë shqipe të pastër, të zhvilluar e të përparuar i takon brezit të autorëve të Rilindjes Kombëtare. Kjo periudhë njihet si periudha e artë e zhvillimit kulturor, letrar e gjuhësor e popullit shqiptar. Të kësaj periudhe janë studimet më të rëndësishme të gjuhës shqipe, fjalorët e gramatikave e para me autorë, si Kristoforidhi, Veqilharqi, vëllezërit Frashëri etj. I kësaj periudhe konsiderohet edhe Mithat Frashëri, i biri i Abdyl Frashëri, apo Lumo Skëndo siç njihet me pseudonimin e tij. Ky personalitet i kohës lindi në Janinë më 25 mars 1880 një patriot i madh, që u rrit në mesin e shumë figurave të ndritura shqiptare brenda dhe jashtë familjes së tij.

Mithat Frashëri ishte mendimtar elitar, politikan, ekonomist, analist, publicist, shkrimtar, historian, autor tekstesh shkollorë, përkthyer, lëvruer i gjuhës shqipe etj. Një pjesë e materialeve të Mithat Frashërit ruhet në dorëshkrim në Arkivin e Shtetit Shqiptar. Një pjesë e konsiderueshme është botuar në organet e shtypit shqiptar brenda dhe jashtë në diasporën shqiptare, por edhe në gjuhë të huaja, në gazetat e revistat më të njohura evropiane. Ai përmes këtyre shkrimeve është mundura ta dëshmojë edhe në botën perëndimore historinë, kulturën, gjuhën e identitetin e shqiptarëve. Një nga qëllimet për të cilat punonte, sikurse brezi i Rilindjes ishte gjuha, shkrim, mësimi dhe ruajtja e saj.

I rritur në një familje ku gjuha shqipe lartësohej, nuk do të mund të qëndronte indiferent karshi gjuhës, karshi laramanisë së përdorimit të saj, karshi shkarjeve të saj. Ndërsa libri e dituria për të ishin më të larta e më të përshtatshme se trimëria. Për diturinë do të shprehej: *“Mos pandehni se me trimëri mund të bëjmë ndonjë punë të madhe. Trimëria e shqiptarëve nuk e shpëtoi as Nishin, as Vranjën, as Leskocën që i rrëmbeu Serbia, as Tivarin e Ulqinin që i*

*gllabëroi Mali i Zi, as Çamërinë që e mori Greqia. shqiptarit, aq sa i duhet buka, i duhet dituria dhe nacionalizma”.*¹

Me pseudonimin Lumo Skëndo hartoi dhe botoi për shkollat shqipe disa libra. Përveç librave shkollor, ai në shumë shkrime të publikuara do të qortonte, do të bënte thirrje për përdorimin e drejtë të shqipes, për largimin e fjalëve të huaja e për kultivimin e saj. Kështu, qysh më 1905, ai boton shkrimet e para për kujdesin që duhet të tregojmë ndaj gjuhës: *“Thjeshtësia është bukuri në gjuhë”, “Shqip kuvendojmë, apo çorbë trazojmë”* etj.

Mithat Frashëri dhe Kongresi i Manastirit

Kontributi i tij për gjuhën shqipe la gjurmë në Kongresin e Manastirit, i cili erdhi si rezultat i nevojës së unifikimi të shqiptarëve me një alfabet të vetëm. Ishte klubi kulturor “Bashkimi” që e mori nismën për një kongres të përmasave të tilla mbarëkombëtare, ku morën pjesë 50 delegatë nga gjithë hapësirat shqiptare. Mithat Frashëri ishte kryetar i këtij kongresi. Më 1908, në gazetën “Ilirja” e boton procesverbalin e Kongresit. Për qëllimin e mbajtjes së këtij Kongresi shprehet: *“Nga çdo a’ne e Shqipërisë ishin ftuar gjithë ata që me dijen, mendjen dhe fuqin’e tyre mund të ndihnin, për t’i dhënë një fund kësaj ngatërrese, abecesë, për të zbukuruar gjuhën dhe për të përhapur mësimin në vendin tonë”.*²

Përdorimit të shumë alfabeleve do të duhej t’i jepej fundi në këtë kongres, sepse sipas tij shqiptarët, për të lënë një emër pas, krijojnë një alfabet të ri, duke ua ndërruar tingullin shkronjave: *“Ashtu edhe shqiptarët! Më i dobëti i shkronjësve, më i gjori fjalërrudhosës, kujtonte se do të linte një emër të pavdekur, duke ngrehur një pakë shkronja të reja dhe duke ndërruar zënë (tingullin) e shkronjave. E kështu dita më ditë po na dilte nga një abece, si kërpudhat pas shiut!”*³ Shqetësimi i tij ishte se libra, fletoret, gazetatat e shkrime e tjera nuk përhapeshin dot në Shqipëri, sepse nuk mund të lexoheshin dhe se nuk është punë e lehtë që njeriu çdo ditë të mësonte një abece të re. Andaj, kongresi kishte për qëllim shërimin e kësaj plage.

Frashëri në një shkrim të botuar në revistën “Ilirja”⁴ mbron qëndrimin se shqiptarët duhet ta përdorin alfabetin latin, madje ai refuzon ta quajë latin, por e quan shqip. Si njeri me njohuri të mëdha nga fusha e gjuhëve të tjera, ai përmend rëndësinë e shpikjes së shkrimit, fillet e tij dhe format e tij. Para mbajtjes së kongresit, Frashëri shprehet se kjo nismë u prit me një ftohtësi, sepse njerëzit mendonin se shqiptarët nuk kishin arritur në atë pikë sa për ta zgjidhur këtë çështje madhore.

Madje, kishte një frikë se delegatët do të mbronin alfabetin që përdorte shoqëria e tyre dhe se kjo nismë do të mbaronte pa arritur qëllimin. E gjithë kjo frikë ka qenë një ëndërr e ligë, një ëndërr e zezë: *“Tani themi se shkrimi i gjuhës sonë u rregullua, themi se abecejat u njësuat; tani do të mbledhim gjithë fuqinë, për të shkruar dhe për të përparuar gjuhën, pa humbur kohën në zihje e në grindje të abeceleve. Tani gjithë dëshira jonë do të jetë për të sjellë në dritë vepra të nevojshme, për të përhapur mësimin dhe për të lulëzuar gjuhën, librat shkollorë, diturakë dhe letrarë.”*⁵

Kontributi i tij vijoi edhe më tutje, me nismën e thirrur nga ai, më 1909 për Kongresin Arsimor të Elbasanit, i cili iu kushtua shkollave shqipe. Shtimi i nevojave, dhe mundësia më e madhe për të hapur shkolla shqipe, përmes të cilave do të mësohej gjuha shqipe e shtyn Frashërin të merrte një nismë të tillë. Përhapjen e përparimin e gjuhës shqipe, ai e shihte nëpërmjet hapjes së shkollave, andaj u dërgoi ftesë të gjitha shoqërive, klubeve e qyteteve për t’i bashkuar forcat për këtë qëllim.

¹ Mithat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 20.

² Mithat Frashëri, *Kongresi i Manastirit*, në: *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 252-253.

³ Po aty.

⁴ Mithat Frashëri, *Çështja e shkronjavet shqip*, në: *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 279-281.

⁵ Mithat Frashëri, *Ç’fituam nga Kongresi i Manastirit*, në: *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 252-253.

Mithat Frashëri për gjuhën letrare

Pas njësimit të alfabetit të gjuhës shqipe në Kongresin e Manstirit, siç dihet, rilindësit i mundonte mungesa e një gjuhe letrare që do të përdorej nga të gjitha anët dhe në librat e shtypur, edhe pse ishin të bindur se koha nuk ishte e përshtatshme për një të gjë të tillë. Në një shkrim të botuar në revistën “Diturija”,⁶ Mithat Frashëri shprehej se sado që gjuha është një dhe e vetme, nuk mund të mohoheshin ndryshimet në mes të dy dialekteve të shqipes, pa i numëruar edhe nëndialektet e tjera. Si rezultat i kësaj, librat e shkrimit e shkruara në dialekte e të folme, shpeshherë mbeteshin pa u kuptuar prej të tjerëve.

Frika e tij ishte, se për një komb të vogël dhe të dobët, ndarjet dhe çarjet e tilla ishin një rrezik i madh që nuk mund të shiheshin me gjakftohtësi, andaj nevoja për gjuhën shqipe të shkruar në një gjuhë të vetme letrare, e cila do të përdorej nga të gjithë shqiptarët anë e mbanë, ishte e madhe. Por si do të realizohej kjo? Duke pasur parasysh thirrjet e disa autorëve që elbasanishtja të bëhej gjuhë letrare për të gjithë, Frashëri hedh dyshime në realizimin e kësaj ideje kur në elbasanishte nuk kishte ndonjë vepër të madhe, as ndonjë ‘shkronjëtores’ që do t’i shpjegonte me thjeshtësi rregullat e kësaj të folmeje.

Ndërsa Kristoforidhi, nuk ka përdorur elbasanishten në veprat e tij, por një gjuhë të përzier për të qenë e kuptueshme nga të gjithë shqiptarët. Ai do të shprehje se “*Edhe pa një vepër të mirë, pa një udhëheqës të mbaruar, s’mund të mësohet me gjithë bukuritë e saj një gjuhë letrare*”.⁷ Ai shpreh mendimin, se qendra e dialektit gegë është Shkodra, sepse shkrimtarët e mësuësit e gegërishtes ose janë shkodranë ose kanë qëndruar disa vjet në Shkodër. Pastaj e vetmja shtypshkronjë që ka ekzistuar në Shqipëri ka qenë në Shkodër, ku janë shtypur shumë libra fetarë krishterë, si dhe librat shkollorë janë shkruar prej shkodranëve.

Por, sipas tij gabimi i tyre ka qenë përdorimi i drejtshkrimit të Kristoforidhit “*dhe ashtu duket gjuha si fare e huaj, një gjuhë që s’flitet asgjëkund në Shqipëri shumë kanë vuajtur mësonjësit me këta libra, duke i ndërtuar sipas gjuhës që flitet, për të lehtësuar mësimin në shkollë*”.⁸ Nëndialektet e gegërishtja, ashtu siç është përmendur edhe në studimet e tjera, kanë dallime nga njëri-tjetri dhe qëndrojnë më larg njëri-tjetrit sesa nëndialektet e toskërishtes dhe këtë shprehet, se e sheh kudo, po të hedhim një vështrim në botimet që ekzistonin. Ndërsa për toskërishten mendon se është një kullim i disa të folmeve dhe se shkrimtarët e saj janë nga pjesë të ndryshme, pa një qendër sikur Shkodra për gegërishten.

Andaj, duke e parë këtë ndarje dialektore në mesin e shqiptarëve, mendon se për gjendjen e përgjithshme në të cilën ndodhen shqiptarët është mirë që përdoren të dy dialektet, porse mësuësit do të duhej të mësonin dhe t’i përdornin të dy dialektet e shqipes, po ashtu t’ua mësonin të tjerëve, ku në tekstet e të dy dialekteve të futeshin edhe pjesë nga dialekti tjetër. Megjithatë, edhe pse ishte një gjendje e tillë “*aspak s’mund të na ndalojnë që tani të nisim e të mendohemi mbi një gjuhë të përgjithshme, e cila do të jetë për tërë shqiptarët, sikundër që kanë bërë kombet e qytetëruara*”.

Ndonëse shqiptarët kanë dy dialekte, dallimet që ekzistonin ndërmjet folësve e besimeve nuk do të duhej të ishin pengesë për një gjuhë të vetme. Gegët dhe toskët, sikurse të krishterët dhe myslimanët do të duhej të bashkoheshin si një trup i vetëm që ka një shpirt dhe shpirti i kombit është gjuha që flet dhe se gjuha shqipe është një gjuhë e vetme, andaj duhet të përdoret një alfabet, një drejtshkrim dhe një terminologji për t’i ikur asimilimit nga kombet e tjera fqinje. Për të arritur këtë, Frashëri mendon se qendra e burimit të shqipes mungon dhe se ka mbetur e huaj dhe e panjohur, “*dialektet e qendrës që janë pa dyshim më të kthjellët, nuk i dimë apo më mirë themi, palcën e shqipes, s’e njohim aspak. Për të vërtetuar dëshirën e nevojshme,*

⁶ Mithat Frashëri, *A do të kemi një të vetëm gjuhë letrare shqip*, në: Vepra të zgjedhura, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 271-274.

⁷ Po aty, f. 272.

⁸ Po aty, f. 273.

që përmendëm, lypset domosdo në rend të parë ta njohim e ta mësojmë qendrën e gjuhës dhe ashtu, pa dyshim, do të mundemi me kohë ta gjejmë ndër këto dialekte të qendrës edhe kërthizën e gjuhën sonë, të cilën duhet ta mësojmë e pastaj ta përhapim nëpër tërë Shqipërinë.”⁹

Mithat Frashëri për fjalët e huaja dhe për drejtshkrimin

Mithat Frashëri në vazhdimësi shkroi e botoi artikuj për gjuhën shqipe, për rëndësinë e ruajtjes dhe kultivimit të saj. Ai bënte thirrje që turqizmat e greqizmat që kishin zënë vend në shqipe të largoheshin, të mos përdreshin kur kemi fjalë shqipe, vetëm në rast se shqipes i mungonin, si: *çorbë, hesap, akoma*. Ai ishte kundër atyre myslimanëve dhe të krishterëve, të cilët e trazonin shqipen me fjalë nga turqishtja e greqishtja. Fjalët e huaja, të botuara jo vetëm në libra e revista, por dhe ato që përdoren në përditshmërinë e njerëzve, në kafe, me miq e me shok, i pengonin, sepse shqiptarët mburren kur përdorin fjalë të huaja gjatë bisedave, “*do me turqisht qoftë, do me greqisht, ata që trazojnë gjuhën shqipe me fjalë të tjera, bëjnë një faj të madh. Bëjnë faj se është një gjë fort e shëmtuar të vërë njeriu fjalë të huaja në një gjuhë. Kur e flet vetë, njeriu s’i vë re: po kur dëgjon një tjetër, që kuvendon një gjuhë të përzier me fjalë të huaja, ahëre e kupton se sa shëmtim ka.*”¹⁰

Në shkrimin “*Të vëmë re kur shkruajmë*”,¹¹ Frashëri bën thirrje që të përdorim drejt fjalët shqipe, që ortografia të jenë në përputhje me rregullat e gjuhës shqipe. Ndonëse para më tepër se 250 vjetësh, Frang Bardhi thoshte se gjuha shqipe po prishej e po bastardohej, në këtë artikull, autori thotë se kjo qëndron edhe sot e kësaj dite. Rregullat e sintaksës së shqipes janë më të thella sesa njerëzit i mendojnë. Në shumicën e Shqipërisë, lajthitje që bëhen në fushën e sintaksës janë të mëdha dhe më tepër në shkrime sesa në të folur. Këto lajthitje nga rregullat e gjuhës që hasen në shkrime, japin një shembull të lig, sepse shkrimi në vend që ta pastrojë dhe ta thjeshtësojë gjuhën po i shton lajthitjet. Kështu që, moskujdesi në të shkruar do të jetë një dëm afatgjatë, sepse lajthitjet do mbesin përgjithmonë. Barra e këtij faji u takon atyre “*që shkruajnë pa marrë pak mundim që të gjykojnë rregullat dhe bukurinë e gjuhës... dhe pandehin se një gjuhë mund të shkruhet krejt ashtu si flitet në qytet a në fshat të tyre*”.¹²

Çështjes së zbatimit të rregullave të ortografisë shqipe, autori i kushton rëndësi të madhe dhe bën thirrje që në të shkruar t’u përmbahemi rregullave. Ai shprehet: “*Një shqiptar kur merr pendën në dorë dhe zë të shkruajë, një mijë të vështira i dalin përpara: nuk gjen dot fjalë, nuk i lidh dot këto fjalë dhe të shumtave s’u di ortografinë.*”¹³ Sipas tij për t’i ditur rregullat e shkrimit, duhet që njeriu të lexojë shumë. Shqiptarëve leximi u mungon, andaj sheh njerëz që ankohen për vështirësitë e të shkruarit me rregulla dhe sheh njerëz që duan të shkruajnë pa lexuar. Kështu që leximi, sipas tij është forma e vetme për ta përmirësuar drejtshkrimin.

Përfundim

Në fund të këtij punimi, konsiderojmë se kontributi i Mithat Frashëri për gjuhën shqipe ishte i madh. Ai ishte pjesë e dy kongreseve të mëdha dhe ishte një lëvruar i gjuhës shqipe. Përmes shkrimeve të ndryshme dhe të tjerë që nuk i kemi shtjelluar në këtë punim, vazhdoi rrugën e babai dhe axhallarëve të tij. Rrugën të cilën e zgjodhi Mithat Frashëri ishte emancipimi kombëtar e kulturor nëpërmjet tri shtigjeve: a. përhapja e librave dhe e gazetave në gjuhën shqipe, b. hapja e klubeve kulturore për sigurinë e veprimtarive politike e kulturore, c. hapjen e shkollave shqipe, për njohjen e identitetit kombëtar shqiptar në botë.

⁹ Po aty, f. 273.

¹⁰ Mithat Frashëri, *Shqip kuvendojmë, apo çorbë trazojmë*, në: Vepra të zgjedhura, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 230-231.

¹¹ Mithat Frashëri, *Të vëmë re kur shkruajmë*, në: Vepra të zgjedhura, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 76-81.

¹² Mithat Frashëri, *Të vëmë re kur shkruajmë*, në: Vepra të zgjedhura, nr. 2, Tiranë, 2018, fq. 76-81.

¹³ Mithat Frashëri, *Të shkruarit shqip*, në: Vepra të zgjedhura, Tiranë, 2018, fq. 254-255.

Referencat

- [1]. Frashëri Mithat, *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 20.
- [2]. Frashëri Mithat, *Kongresi i Manastirit*, në: *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 252-253.
- [3]. Frashëri Mithat, *Çështja e shkronjavet shqip*”, në: *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 279-281.
- [4]. Frashëri Mithat, *Ç’fituam nga Kongresi i Manastirit*, në: *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 252-253.
- [5]. Frashëri Mithat, *A do të kemi një të vetëm gjuhë letrare shqip*, në: *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 271-274.
- [6]. Frashëri Mithat, *Shqip kuvendojmë, apo çorbë trazojmë*”, në: *Vepra të zgjedhura*, nr. 1, Tiranë, 2017, f. 230-231.
- [7]. Frashëri Mithat, *Të vëmë re kur shkruajmë*, në: *Vepra të zgjedhura*, nr. 2, Tiranë, 2018, fq. 76-81.
- [8]. Frashëri Mithat, *Të shkruarit shqip*, në: *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2018, fq. 254-255.